4° porta il sigillo / timbro di

C.C. I.A.A. - ALESSANDRIA

Attestato

5° a ALESSANDRIA

6° li

59. 2019

7° da

RAIMONDI GABRIELLA

8° N°

1339 /

9° Sigillo / Timbro



10° Firma
Assistente


(Vula e Dhomës së Tregtisë Alessandria)

Kopertina fq. 1

Dhoma e Tregëtisë, Artizanatit dhe Bujqësisë Alessandria

Të dhënat e identifikimit të kërkuara

Përdorues : CAL1140
Emri i subjektit : WELDER PIPELINE CONTRACTOR SH.P.K
Data e aplikimit : 05/09/2019
Objekti i kërkesës :
I gjithë dokumenti
Total i faqeve të faqeve të kërkesës: 32



Informacioni referues i praktikës

Kodi fiskal : 02387870062
CCIAA/ NUMRI Rea : AL/000251445
Emri : WELDER PIPELINE CONTRACTORS SH.P.K
Data e praktikës : 11/01/2013
Protokoll : AL/RI/PRA/2013/000001037

Informacion referues per dokumentet/ kërkesën

Data e dokumentit : 08/01/2013
Lloji i Aktit : Akt themelimi

Të dhënat e nënshkruesit të dokumentave të kërkuara

Lloji i dokumentit : Akt themelimi
Emri : LAURA

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Mbiemri : MAGAGLIO
Kodi fiskal : MGGLRA61M53F965T
Enti Çertifikues : Dhoma Kombëtare e Noterisë e Autorizuar për Çertifikim.
Nr. Serial i Çertifikatës : 2405
Data e verifikimit : 14/01/2013
Data e skadencës : 24/10/2014
Emri i dokumentit : 001_akt_themelimi.pdf
Emri original i dokumentit (skedar) : AL.281660.WN1273.M13111J1107.001.PDF.P7M



Lloji i dokumentit : Mandat pagese
Emri : LAURA
Mbiemri : MAGAGLIO
Kodi fiskal : MGGLRA61M53F965T
Enti Çertifikues : Dhoma Kombëtare e Noterisë e Autorizuar për Çertifikim
N.serial i çertifikates. : 2405
Data e verifikimit : 14/01/2013
Data e skadencës : 24/10/2014
Emri i dokumentit : 002_faturë_pagese.pdf
Emri origjinal i dokumentit (skedar) : AL.281660.WN1273.M13111J1107.002.PDF.P7M

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Taksa e pullës është e parashikuar në dekretin e datës 22 shkurt 2007 nga M.U.I repertori nr.10800 Koleksioni nr.5900

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

REPUBLIKA E ITALISË

Në datën 08 Shkurt 2013, në Gavi, Sheshi Dante, hyrja nr.8/20

Para meje

Laura Magaglio

Notere në Novi Ligure, e regjistruar në dhomën e noterisë të Alessandrisë, Acqui Terme dhe Tortona, u paraqitën palët e mëposhtme:

- 1) RICCI VINCENZO, lindur në Sizzi (LT) në 12 Mars 1943, banues në Gavi (AL), ruga Piona nr.1/1,

Kodi fiskal RCC VCN 43C12 I712E;

i cili deklaron se është i martuar në regjimin e pasurisë së përbashkët;

- 2) BAZZANI ANTONIETTA, lindur në Gavi (AL) në 10 Dhjetor 1944, banuese në Gavi (AL), rruga Piona nr.1/1,


Kodi fiskal BZZ NNT 44T50 D944O;

E cila deklaron se është e martuar në regjimin e pasurisë së përbashkët.

Palët u paraqiten para meje, të dy shtetas italianë, unë noteri e vërtetoj dhe me kartat e tyre të identitetit, bien dakort dhe parashikojnë si më poshtë:

- 1) Midis RICCI VINCENZO dhe BAZZANI ANTONIETTA është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur: "WELDER PIPELINE CONTRACTOR SH.P.K."
- 2) Shoqëria e ka selinë në Gavi (AL)

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Për qëllimin e vetëm të regjistrimit në Regjistrin Tregtar palët më deklarojnë se adresa aktuale e shoqërisë është në rrugën Piona, Hyrja nr.1

Transferimi i zyrës në të njëjtën bashki nuk sjell modifikimin e aktit të themelimit.

3) Shoqëria ka për qëllim kryerjen e aktiviteteve të mëposhtme:

Ndërtimin e tubacioneve të gazit dhe naftës për shpërndarjen e gazit për përdorim civil dhe industrial, ndërtimin e impjanteve civile dhe industriale në përgjithësi duke përfshirë edhe punimet e saldimit, mirëmbajtje të zakonshme dhe/ose të jashtëzakonshme .

Gjithashtu mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, financiare, mobiliare dhe imobiliare, si në Itali edhe jashtë saj, në vendet të cilat mund të jenë të përshtatshme për realizimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe interesave të saj me të tjera shoqëri dhe biznese (filiale) të cdo lloji apo natyre të ngjashme por në çdo rast të lidhura me shoqërinë kryesore, me përjashtim të veprimtarive të parashikuara në ligjin nr. 1/1991 dhe në Dekretin legjislativ nr.385/1993.

4) Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë deri në 31 Dhjetor 2050.

5) Kapitali i regjistruar i shoqërisë do të jetë 10.000,00 (dhjetë mijë presje zero zero),

të pajtuar plotësisht të dy ortakët me përqindjen e mëposhtme të kuotave:

- Z. RICCI VINCENZO zotëron 99% (nëntëdhjetë e nëntë përqind) të kapitalit, e barasvlefshme me 9.900,00 (nëntëmiqe e nëntëqind presje zero zero) euro;
- Znj.BAZZANI ANTONIETTA zotëron 1%(një përqind) të kapitalit, e barasvlefshme me 100,00 (njëqind presje zero zero) euro;

6) Palët deklarojnë se kanë paguar nëpërmjet Bankës së Legnanos- Agjensia e Gavit në propocion me kuotat e sipërpërmendura për secilin ortak, brenda kapitalit aksionar në bazë të Nenit 2464 të Kodit Civil, e vërtetuar nga dokumenti i Bankës lëshuar në datë 7 Janar 2013 në kopje e bashkëlidhur me origjinalin vërtetuar nga unë Noteri në datën e sotme duke ja bashkëngjitur kësaj shkrese referuar pikës “A”, vënë në dijeni për piken ku parashikohet heqja dorë e shprehur, bërë nga palët e paraqitura.

7) Pjesëmarrja e secilit ortak përcaktohet në propocion me kuotat që zotëron secili si janë parashikuar më lart.

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



- 8) Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator i vetëm që do të kryejë këtë detyrë deri në revokim ose dorëheqje, të cilit i atribuohet përfaqësimi i shoqërisë. Në pozicionin e administratorit të vetëm emërohet Z. RICCI VINCENZO.

Administratori pranon emërimin dhe deklaron se nuk do të gjendet në asnjë nga kushtet e parashikuara nga ligji si jo të ligjshme.

- 9) Viti financiar mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti; viti i parë financiar mbyllet në 31 Dhjetor 2013.
- 10) Ortakët autorizojnë Z. RICCI VINCENZO të tërheqë nga Banka e Legnano-Agjensia e Gaviti të lëshuar nga këta të fundit, shumën prej 10.000,00 (dhjetë mijë presje zero zero), që përkon me shumën e paguar për kapitalin aksionar.

Z. RICCI VINCENZO është emëruar për të bërë shtesat në aktin aktual, plotësimet, ndërprerjet ose modifikimet që mund të jenë të nevojshme për regjistrimin në Regjistrin e Shoqërive.

- 11) shuma e përafërt e shpenzimeve për themelimin e shoqërisë e ngarkuar në të njëjtën shumë prej 2.500,00 (dy mijë e pesëqind presje zero zero) euro

- 12) Ortakët, në bazë të informacionit të marrë nga neni 13 i Dekretit Legjislativ 196/2003, japin pëlqimin për përdorimin e të dhënave personale (konfidenciale ose gjyqësore) si edhe ruajtjen e tyre edhe në dokumenta informatikë, në arkivin e noterisë sime.

- 13) Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet nga rregullat e mëposhtëme:

NORMAT QË RREGULLOJNË FUNKSIONIMIN E SHOQËRISË

SELIA, EMËRTIMI,OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

NENI 1

Shoqëria vepron nën emrin “WELDER PIPELINE CONTRACTOR SH.P.K”

NENI 2

Shoqëria e ka selinë në Gavi (AL).

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Organi administrativ ka funksion vendimarrës dhe për të vepruar në ambientet operative (për shembull degët, filialet ose zyrat administrative pa përfaqësues të përhershëm) dhe të transferojë selinë e shoqërisë në Bashkinë e sipërpërmendur; ndryshe nga kjo janë ortakët që vendosin për selitë e bizneseve sekondare ose për transferimin e selive në bashki të tjera të ndryshme nga selia e sipërpërmendur (selia qëndrore).

NENI 3

Shoqëria ka për qëllim zhvillimin e aktivitetit:

ndërtimin e tubacioneve të gazit dhe naftës për shpërndarjen e gazit për përdorim civil dhe industrial, ndërtimin e impianteve civile dhe industriale në përgjithësi duke përfshirë edhe punimet e saldimit, mirëmbajtje të zakonshme dhe/ose të jashtëzakonshme .

Për ushtrimin e aktivitetit, zhvillimin e veprimtarisë shoqëria mund të ndërhyjë në çfarëdo operacion të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, financiare dhe tregëtare, kështu që , mund të marrë, direkt ose indirekt, interesa ose aksione në kompani ose ndërmarrje me objekt veprimtarie të njëjtë, të ngjashme ose të lidhura me njëra tjetrën, të marrë hipoteka pasive dhe aktive, me subjekte private ose institucionet e kreditit, me përjashtim të rasteve që lidhen me mbledhjen e kursimeve, të parashikuara në ligjin nr.1, dt.2 Janar 1991 dhe artikullit 18-ter i ligjit nr.216, dt. 7 Qershor 1974, dhe çdo përjashtimi tjetër të parashikuar në ligjet aktuale dhe që do parashikohen në të ardhmen.

NENI 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë deri në 31 Dhjetor 2050 por mund të shkrihet ose të zgjatet një ose disa herë me vendim të ortakëve.

KAPITALI

NENI 5

Kapitali themeltar do të jetë 10.000,00 (dhjetë mijë presje zero zero) euro i ndarë në pjesë me vlerë nominale jo më të vogël se 1(një) euro.

Ky kapital mund të rritet me vullnetin e ortakëve me vendim të asamblesë me më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar, përmes kontributeve të reja ose alokimit të rezervave dhe fondeve

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



të tjera të regjistruara në pasqyrat financiare për kapitalin, kur është në dispozicion; në këtë rast përqindja e secilit ortak mbetet e pandryshuar në rast të vendimit për rritje të kapitalit përmes kontributeve të reja, varet nga anëtarët e regjistruar në regjistrin e kompanive për të justifikuar statusin e tyre si anëtar duke treguar një dokument blerje të depozituar sic duhet në regjistrin e kompanisë për të vërtetuar të drejtën që ka mbi pjesën që zotëron; anëtarët që bëjnë një kërkesë të njëjtë në kohën e pajtimit, është gjithashtu e drejta për t'u pajtuar me pjesën e rritjes së kapitalit që mund të mos kenë qënë dakort një pjesë e aksionerëve, në përpjestim me pjesën që zotërojnë. Edhe anëtarët kanë të drejtë të drejtë të parashikojnë shprehimisht zgjedhjen e rritjes, përveç rastit të rritjes së parashikuar në ish nenin 2482 të kodit civil, që gjithashtu mund të zbatohet duke ofruar kuota ndaj të tretëve; në këtë rast aksionerët të cilët nuk bien dakort kanë të drejtën e tërheqjes në bazë të artikullit 2473 të kodit civil.

Mund të jepen të mira në natyrë, kredit ose çfarëdo sendi aktiv që ka vlerë sipas vlerësimit ekonomik sipas nenit 2464 të kodit civil.

Në rast të zvogëlimit të kapitalit nga humbjet, mund të depozitohet preventivi përkatës pranë selisë qendrore të organit administrativ mbi gjendjen pasurore të shoqërisë dhe të kontroleve nga organi përkatës mbikëqyrës, duke marrë parasysh që ky preventiv apo dokumenta të tjerë bashkëngjitur, të prezantohen në Asamble.

FINANCIMET E ORTAKËVE

NENI 6

Ortakët mund të kryejnë financimin "raste hipotekore" të kompanisë, të kontribuojnë me kontribute të pakthyeshme ose kontribute kapital në llogarinë e ardhshme të rritjes së kapitalit, në përputhje me rregullat, me referencë të vecantë për ato që rregullojnë mbledhjen e kursimeve nga publiku.

Në rastin e pagesave në llogarinë e kapitalit, shuma përkatëse mund të përdoret për të mbuluar humbje ose drejtpërdrejt për rritje të kapitalit të ndonjë importi, dhe kjo i nënshtrohet aprovimit nga mbledhja e asamblesë.

Kontributet e përmendura mund të bëhen edhe në mënyrë jo propocionale, jo në përpjestim me pjesëmarrjen në kapital dhe do ta bartin pa interes derisa ortakët të vendosin të kundërtën.

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Në çdo rast do të zbatohet neni 2467 i kodi civil.

SELIA

NENI 7

Për të gjitha marëdhëniet me shoqërinë, adresat e ortakëve, administratorit, kryetarit dhe ekspertit dhe revizorit, nëse emërohen, është adresa që rezulton në regjistrin e bizneseve, ose për ortakët që nuk janë regjistruar akoma në regjistrin e biznesit vendbanimi që rezulton nga titulli i kualifikimit me kusht që të depozitohet me të njëjtën adresë. Në atë adresë dërgohet çdo komunikim edhe nëpërmjet faksit, postës elektronike ose mënyra të tjera të ngjashme, dërgimet tek subjektet e përmendura më lart duhet të bëhen me anë të numrit faks, adresa e postës elektronike ose çfarëdo numri që është lënë për t'u komunikuar në të dhënat e subjektit.

Për këtë qëllim kompania krijon një “ libër të dhënash” ku shënohen përvec adresës së dhënë nga ortakët edhe adresa elektronike dhe numra, me detyrimin e organeve administrative për përditësimin e tyre në çdo kohë si dhe komunikimit relativ dhe të papritur nga të interesuarit në regjistrin e biznesit. Është detyrë e ortakut të komunikojë çdo ndryshim pa vonesa në regjistrin e biznesit.

PJESËMARRJA NË SHOQËRI

NENI 8

Është e lejuar edhe pjesëmarrja në mënyrë jo propocionale e kontributeve. Për më tepër, në rast të mungesës së specifikimit të pjesëve në këtë rast nga shumica e aksionerëve që janë ortakë pjesët e kontributeve të secilit konsiderohen në vlerë të barabartë.

Të drejtat në shoqëri të çdo ortakut do të jenë në propocion me pjesën e kuotave që zotërojnë.

Në rastin e bashkëpronësisë së një pjese, të drejtat e bashkë-pronarëve do të zotërohen nga një përfaqësues i përbashkët i emëruar sipas rregullave të përcaktuara në nenin 1105 dhe 1106 të kodit civil.

NENI 9

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Investimet sociale jane lehtësisht të transferueshme, të plota ose në pjesë, midis të gjallëve të çdo titulli, nëse transferuasi është bashkëshort, duke u ngjitur ose zbritur nga një vijë e drejtë nga anëtari transferues.

Përvec rasteve të përmendura më lart në rastin e caktimit të një vlerësimi total ose të pjesshëm të aksioneve, varet nga aksionerët e regjistruar në regjistrin e bizneseve ose kur justifikohet me anë të një titulli ose vërtetimi që është depozituar në regjistrin e bizneseve e drejta për të refuzuar pjesëtimin e kuotave.

Në rast se ndonjë ortak do të shesë të gjitha ose një pjesë të aksioneve që zotëron, duhet të lajmërojë Organin Administrativ dhe ortakët e tjerë nepërmjet letrës rekomande në adresën që rezulton si selia e biznesit në Regjistrin e Bizneseve dhe që përmban tregues të subjektit aksionar në shitje, të dhënat e blerësit, të çmimit të shitjes dhe çdo të dhëne tjetër të tjetërsimit të kuotave.

Komunukimi vlen si një propozim kontraktual për ortakët e tjerë të cilët mund të vendosin përfundimin e kontratës duke zgjedhur të jenë ata blerës të aksioneve.

Parablerja duhet të ushtrohet brenda objektit të shitjes, duke i dërguar një letër ortakut cedues, Organit Administrativ dhe ortakëve të tjerë, pas 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja e komunikimit, duke u zhveshur nga e drejta për të hequr dorë, për të bërë refuzimin e parë.

E drejta e refuzimit fitohet në rast se ka kthim përgjigjeje pas kalimit të afatit 60 (gjashtëdhjetë) ditor nga marrja dijeni, duke i dhënë ortakut të drejtën për të marrë pjesë sipas kushteve të parashikuara në komunikimin e paraqitur nga ortaku shitës. Tjetërsimi i kuotave duhet gjithsesi të bëhet brenda 30(tridhjetë) ditëve nga dita e refuzimit të ofertës, i shprehur ose i pohuar me heshtje, me të drejtën e parablerjes.

Në rast të refuzimit nga disa ortakë, këta të fundit do të ndajnë aksionet objekt shitjeje në mënyrë që raporti i aksioneve të tyre të mbetet i pandryshuar.

Në rast të tjetërsimit të kuotave falas ose në mënyrë tjetër përvojë parave, ortakët të cilët refuzojnë blerjen si më sipër, do të blejnë aksionet duke paguar një shumë specifike me anë të një marrëveshje midis tyre, në rast të mos rënies dakort me mënyrën e përcaktuar nga ndonjë vlerësues emëruar nga Kryetari i Gjykatës së rrethit në të cilin ka selinë shoqëria, sipas ligjit, me kërkesë të pjesës së ortakëve më të interesuar.

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Në mungesë të ushtrimit të së drejtës së refuzimit të parë, ortakut mund t'ia transferojë kuotat të tretëve që nuk janë aksionerë në rastin e shprehjes së interesit nga komunikimi i parë.

Aksionet janë të tjetërsueshme për shkak të vdekjes, si në veçanti ashtu edhe në titull universal; ky tjetërsim është i parashikuar në artikullin 2284 të Kodit Civil.

Procedura e parashikuar në nenin më sipër do të zbatohet edhe për rastet e mëposhtme:

- Shoqëria mund të vazhdojë veprimtarinë edhe me 1 (një), më shumë ose të gjithë trashëgimtarët e ortakut të vdekur;
- Në rast të likuidimit, trashëgimtarët kanë të drejtë të rimbursohen në bazë të pjesës që zotëron ortakut që ka vdekur në përpjestim me pjesën që zotëron sipas nenit 11);
- Pagesa e shumës së likuiduar ndaj trashëgimtarëve duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga momenti i përcaktimit të shumës që iu takon.

Vendimi për vazhdim ose për likuidim të pjesëve do të merret me votat e ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit pa përfshirë pjesën e ortakut të vdekur.

Shoqëria nuk mund të mbajë shënime për tjetërsimin e pjesëve, në rast se nuk zbatohen kushtet e parashikuara në këtë nen.

TËRHEQJA E ORATKUT

NENI 10

Ortakut mund të tërhiqet vetëm në rastet e parashikuara në ligj.

Vullneti për t'u tërhequr duhet t'i komunikohet organit administrative me letër rekomande me njoftimin për t'u tërhequr, dërguar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga regjistrimi në Regjistrin e Bizneseve për vendimin që legjitimon tërheqjen, ose në librin e vendimeve të ortakëve, kur kërkesa për regjistrim ose regjistrimi nuk është bërë, nëse fakti që e legjitimon tërheqjen është ndryshe nga një vendim, nga dita që është marrë dijeni për faktin që e legjitimon heqjen dorë.

Në rekomande duhet të shënohen të gjitha të dhënat e ortakut që heq dorë, adresa ku do të marrë njoftimet nëlidhje me procedimet dhe zgjidhjen ose marrëveshjen që e legjitimon.

Pjesët për të cilat po kërkohet heqja dorë nuk duhet të jenë shitur më parë.

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Heqja dorë nuk mund të jetë pranuar, në rast se është pranuar është e paefektshme kur shoqëria revokon vendimin që legjitimoi.

NENI 11

Ortaku që heq dorë ka të drejtë të rimbursohet për pjesën që zotëron, përcaktuar duke marrë parasysh gjendjen e shoqërisë, fitimit të saj, të vlerave materiale dhe jomateriale që zotëron, të pozicionit të saj ekonomik në treg ose çfarëdo rrethanë dhe kushtesh që merren parasysh në përcaktimin e vlerës së tregut; në rast të mos rënies dakort, të pavendosshmërisë zhillohet në bazë të një raporti zyrtar nga një ekspert i emëruar nga Gjykata në bazë të ligjit, me kërkesën e palës më të interesuar.

Rimbursimi duhet të bëhet sipas metodave të parashikuara në ligj, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për të hequr dorë.

Kjo mund të bëhet gjithashtu me blerje nga ortakët e tjerë që kanë pjesë në shoqëri ose nga të tretë të pranuar nga të gjithë ortakët.

Nëse kjo nuk ndodh rimbursimi bëhet duke përdorur rezervat në dispozicion, kapitali aksionar do të zvogëlohet në përputhje me rrethanat; në këtë rast aplikohet neni 2482 i Kodit Civil, nëse në bazë të këtij neni nuk është e mundur të rimbursohet ortaku për pjesën e tij, shoqëria kalon në post likuidim.

VENDIMET E ORTAKËVE

NENI 12

Ortakët marrin vendime të lejuara nga ligji dhe normat/rregullat e shoqërisë si dhe argumenta e paraqitura nga ata me miratimin e 1 (një) ose më shumë administratorëve ose nga disa ortakë që zotërojnë 1/3 e kapitalit, në bazë të nenit 2479 të Kodit Civil.

NENI 13

Janë gjithmonë në kompetencë të ortakëve:

- a) Aprovimi i bilancit dhe shpërndarja e fitimit;
- b) Emërimi dhe shkarkimi i administratorëve, pa cënuar të drejtën e administrimit të kompanisë që mund t'i atribuohet të vetmit ortak;

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



- c) Emërimin e mundshëm të auditorit ligjor dhe kryetarit të bordit të auditorëve ligjorë dhe revokimin e tyre;
- d) Modifikimin e aktit të themelimit;
- e) Vendimin për të blerë operacione që çojnë në modifikimin e objektit të veprimtarisë ose të ndonjë modifikimi të rëndësishëm të të drejtave të aksionerëve.
- f) Emërimin dhe revokimin e likujduesve dhe të kriterëve të procesit të likujdimit;
- g) Vendimmarrje kur ka konflikt interesi midis organit administrativ dhe 1 (një) nga anëtarët e tij dhe shoqërisë;
- h) Vendimet që ligji parashikon si të deyrueshme në kompetencë të ortakëve.

Vendimet e ortakëve të sipër përmendura duhet të miratohen me rezolutë të mbledhjes së aksionerëve me votat e ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit, pa qënë në kundërshtim me atë që ligji parashikon ndryshe për marrjen e vendimeve, ku është specifikuar mazhoranca....

Ka të drejtë të ndërhyjë në asamble çdo ortak jo debitor në kryerjen e kontributeve, që është i regjistruar në regjistrin e bizneseve ose me titull (kualifikimin) e duhur të depozituar në regjistrin e bizneseve, që tregon se vota e tij ka një vlerë proporcionale me pjesëmarrjen e tij në kompani.

ASAMBLEJA

NENI 14

Asambleja e ortakëve kryen veprimtarinë në bazë të rregullave të mëposhtme:

- a) Asambleja mund të mbledhet edhe jashtë selisë së shoqërisë, brenda territorit italian;
- b) Asambleja mund të mbledhet nga organi administrativ duke njoftuar për ditën, vendin, orën e takimit dhe listën e temave që do të diskutohen, duke jua dërguar çdo ortaku të paktën 8 (tetë) ditë para ditës së mbledhjes; njoftimi duhet të dërgohet me letër rekomande ose çdo mjet tjetër të përshtatshëm për të siguruar provën e marrjes së lajmërimit, lajmërim i cili dërgohet në adresën e depozituar prej tyre në regjistrin e bizneseve. Përveç letrës rekomande mënyrat e tjera që mund të përdoren për njoftimin janë faks, posta elektronike, numri i telefonit i depozituar në Regjistrin Tregtar nga vetë ortaku: në rast paafësie osë mosveprimi të organit administrativ, asambleja mund të

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



mbledhet nga Organi i Kontrollit nëse është emëruar ose nga 1 (një) ortak. Në lajmërimin e thirrjes mund të parashikohet një datë tjetër për një thirrje të dytë, në rastin kur në mbledhjen e parashikuar në thirrjen e parë asambleja nuk rezulton e mbledhur ligjërisht, gjithsesi edhe në thirrjen e dytë vlejnë të njëjtat shumica të parashikuar në thirrjen e parë.

- c) Në çdo rast Asambleja konsiderohet e mbledhur rregullisht kur në të merr pjesë i gjithë kapitali i shoqërisë, janë të pranishëm të gjithë Administratorët dhe anëtarët e Organit të Kontrollit, nëse janë emëruar, janë të pranishëm ose të informuar dhe kur askush nuk e kundërshton trajtimin e çështjes. Nëse Administratori dhe Kryetari (kur janë emëruar) nuk e kryesojnë personalisht mbledhjen , duhet ta lënë me shkrim që të kryesohet nga të tjerë ortakë, duke lënë çdo informacion për temat e mbledhjes.
- d) Ortakët mund të përfaqësohen në asamble nga një person tjetër me autorizim dhe që duhet të ruhet nga shoqëria, autorizimi nuk mund të jepet nga organi administrativ, por nga organi i kontrollit, aty ku ekziston; në këtë rast zbatohet neni 2372 i Kodit Civil të parashikuar për shoqërisë , kur është i zbatueshëm;
- e) Është Kryetari i Asamblesë ai që konstaton nëse asambleja është mbledhur siç duhet, të sigurohet për identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, të drejtojë dhe të rregullojë zhvillimin e asamblesë dhe të sigurohet për rezultatet e votimeve dhe t'i deklarojë ato.
- f) Asambleja kryesohet nga Administratori unik ose nga Kryetari i Bordit Drejtues, dhe në mungesë të tyre , nga një tjetër person i caktuar nga të pranishmit që zotërojnë pjesën më të madhe të kuotave.
- g) Asambleja emëron një sekretar, që nuk është ortak, që harton procesverbalet, firmosur nga ky i fundit dhe nga kryetari; në rastet që është parashikuar nga ligji dhe kryetari e konsideron të përshtatshme, procesverbali pregatitet nga një noter.
- h) Asambleja duhet të mbledhet të paktën një herë në vit për miratimin e bilancit, brenda periudhës së përcaktuar me ligj.

ADMINISTRATORËT

NENI 15

1. Shoqëria mund të administrohet në alternativë, me vendim të ortakëve në momentin e emërimit:

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



- a. Nga një administrator i vetëm;
- b. Nga një Këshill administrimi i përbërë nga dy deri në pesë anëtarë, sipas numrit të përcaktuar nga ortakët në momentin e emërimit;

Administratorët, sic e parashikon dhe neni 2382 i Kodit Civil, mund të jenë edhe personat që nuk janë ortakë të shoqërisë dhe me të drejtë rizgjedhjeje.

Këshilli administrativ mbetet në detyrë deri në revokimin e tij ose dorëheqjen ose deri në përfundimin e kohëzgjatjes së caktuar nga ortakët në momentin e emërimit.

Administratorët janë të revokueshëm në çdo moment nga ortakët, pa prekur të drejtën e kompensimit në rast të pushimit për një kohë të pacaktuar dhe pa arsye.

Përfundimi i mandatit të administratorit për shkak të përfundimit të afatit ose të dorëheqjes hyn në fuqi në momentin që Organi Administrativ është rregulluar.

Në çdo rast administratorët qëndrojnë në detyrë, ata që janë pushuar dhe Organi administriv me vendim të ortakëve, ringritjen e Këshillit administrativ sa më parë të jetë e mundur, brenda 30(tridhjetë) ditëve.

Kur shoqëria administrohet nga një Këshill Administrativ, nëse për çdo arsye është humbur më shumë se gjysma e administratorëve në këtë rast shkarkohet Këshilli.

Në fund të emërimit të organit të ri të organit administrative, administratorët e larguar mund të blejnë aktet e administrimit.

Administratorët nuk mund të marrin statusin e ortakut në kompanitë konkurrenente, as të hapin një biznes që konkuron shoqërinë për interesin e tyre ose të të tretëve, as të jenë administratorë ose drejtorë të përgjithshmën në shoqëritë konkurrenente, vetëm në rast se janë autorizuar/lejuar në momentin e emërimit të tyre ose me vendim të ortakëve.

Në rast mosrespektimi të këtij rregulli, administratori mund të revokohet nga zyra dhe të mbajë përgjegjësi për dëmet.

NENI 16

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Bordit Drejtues i është dhënë fuqi e plotë për të vepruar sipas kufizimeve që parashikon akti dhe ligji po ashtu e drejta për të apeluar në gjykatë për mosrespektimin e statutit dhe rregullave për tjetërsimin e aksioneve.

NENI 17

Bordi Drejtues rregullohet nga rregullat e mëposhtme:

- a) Nëse nuk e kanë bërë ortakët në momentin e emërimit, Bordi Drejtues zgjedh nga anëtarët e tij një Kryetar. Mund të emërojë një ose më shumë administratorë në limitet e vendosura nga ligji në bazë të nenit 2381 të Kodit Civil; emërimi i Kryetarit ose Zëvendës Kryetarit nuk është i papajtueshëm me atë të administratorit.
- b) Bordi Drejtues mblidhet në selinë e shoqërisë ose diku tjetër, brenda territorit Italian, kur presidenti e shikon të nevojshme ose kur të paktën një nga administratorët e kërkon me shkrim.
- c) Këshilli mblidhet me kërkesë të Kryetarit me anë të një komunikimi të shkruar në të cilin shkruhet data, vendi dhe ora e mbledhjes dhe rendi i ditës ju dërgohet të gjithë administratorëve dhe anëtarëve të tjerë të organit të kontrollit, të paktën 5 (pesë) ditë para ditës së mbledhjes dhe në rast urgjence të paktën 24(njëzet e katër) orë para; njoftimi mund të komunikohet edhe me faks, postë elektronike, numrat e telefonit të cilët janë depozituar në librat e administratorit, në rast të pamundësisë së Kryetarit për të qënë i pranishëm, Kryetari mund të thirret me kërkesën e njërit prej administratorëve;
- d) Në rast të mungesës së një fjalimi formal, Bordi diskuton për tema të vlefshme kur të jenë të pranishëm të gjithë administratorët dhe anëtarët e organit të kontrollit;
- e) Vendimet e Këshillit merren nga shumica e votave të administratorëve prezentë; në rastin kur këshilli përbëhet nga një numër i barabartë anëtarësh, në rastin kur nuk përputhet vota e Kryetarit me atë të Bordit Drejtues .
- f) Bordi Drejtues emëron një sekretar, edhe nga jashtë bordit, që harton procesverbalin e rezolutave dhe firmos bashkë me kryetarin;
- g) Bordi Drejtues duhet të mblidhet për miratimin e projekt-buxhetit edhe në rastet kur e parashikon ligji.

NENI 18

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Administratorët kanë të drejtë të rimbursohen më shpenzimet e bëra për zyrën e tyre; ortakëve gjithashtu duhet t'u caktohet një buxhet vjetor fiks dhe në përpjestim me fitimet e vitit.

ORGANI I KONTROLLIT

NENI 19

Nëse e shohin të arsyeshme apo nëse është e detyrueshme në bazë të ligjit, ortakët emërojnë, duke përcaktuar tagrat dhe kompetencat përkatëse, përfshirë këtu auditimin e llogarive, një organ kontrolli ose auditues, në bazë dhe në zbatim të nenit 2477 të Kodit Civil.

Zbatohen rregullat e Kodit Civil, normat dhe rregullat të parashikuara në ligj.

Organi i kontrollit me vendim të ortakëve por pa qënë në kundërshtim me statutin herë pas here mund të vendosë:

- Për kontroll monokratik ose nga një Organ kolegjal për formimin dhe funksionimin e të cilit aplikohen ligjet mbi shoqëritë aksionere.
- Funksioni i auditimit mund t'i besohet si një personi fizik ashtu edhe një shoqërie audituese, të regjistruar në regjistër;
- Funksioni i kontrollit legal do të bëhet nga organi i kontrollit (monokratik ose kolegjal) dhe funksioni i kontrollit ligjor do t'i besohet (një personi fizik ose një shoqërie audituese ligjore)

VITI FINANCIAR-BILANCI-FITIMET

NENI 20

Viti financiar nis në datë 1(një) janar dhe përfundon në datë 31(tridhjetë e një) dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo viti financiar, administratorët pregatisin bilancin e shoqërisë në bazë të ligjit. Bilanci aprovohet me vendim të ortakëve brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve nga data e mbylljes së vitit financiar.

Nëse, sipas organit administrativ, nevoja të vecanta e kërkojnë, dhe gjithësi brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara nga ligji, bilanci mund të aprovohet me vendim të

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



ortakëve brenda afatit maksimal prej 180(njëqind e tetëdhjetë) ditëve parashikuar nga ligji.

NENI 21

Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci, pasi është zbritur të paktën 5% (pesë përqind) që do të shkojë për rezervën ligjore derisa kjo të ketë arritur një të pestën e kapitalit, do të ndahen midis ortakëve në përputhje me pjesëmarrjen e tyre, kundrejt vendimit të ortakëve.

SHPËRBËRJA

NENI 22

Shoqëria shpërbëhet me rezolutë të mbledhjes së aksionerëve duke votuar aksionerët që zotërojnë 2/3 (dy të tretat) e kapitali, dhe në rastet e tjera që parashikon ligji.

LIKUJDIMI

NENI 23

Rregullat për likuidimin, emërimin e likujduesve dhe personave që do të likujdohen si edhe për përcaktimin e vlerës së kompensimit do të vendosen me anë të mbledhjes së ortakëve.

KONFLIKTET E INTERESIT

NENI 24

Të gjitha mosmarrëveshjet midis Ortakëve dhe Shoqërisë, Ortakëve dhe Asamblesë, Ortakëve dhe Administratorit, likujduesve dhe kryetarëve duke pasur parasysh të drejtat e tyre, do të zgjidhen nga një Arbitër Unik, i emëruar nga Presidenti i Urdhrit të Kontabilistëve të Autorizuar të rrethit ku ka selinë biznesi.

Në rast të mos emërimit, do të jetë jetë gjykata e rrethit të selisë së shoqërisë që do të zgjidhë mosmarrëveshjet.

Selia e arbitrazhit është e palëvizshme, në provincën ku ka selinë dhe shoqëria.

Arbitri i emëruar vendos sipas ligjit pas 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita e emërimit, përgjigjet edhe për shpenzimet e arbitrazhit.

Klauzola e parashikuar më sipër nuk rregullon mosmarrëveshjet për të cilat ligji parashikon ndërhyrjen e detyrueshme të Prokurorisë.

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



REFERIMI NË LIGJ

NENI 25

Për sa nuk është parashikuar në këtë statut do të rregullohet nga normat e parashikuara në ligje dhe Kodin Civil.

Me kërkesën e ortakëve unë Noteri, mora këtë akt dhe jua lexova Zoterinjve bashkë-ortakë, duke ju përgjigjur pyetjes sime ata e njohin dhe janë dakort me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, me mua Noterin e nënshkruan në orën 11:50 nga këto 7 (shtatë) faqe janë shkruar me makinë shkrimi me bojë që nuk fshihet nga një person që i besoj dhe pjesërisht e shkruar me dorë nga noteri nga faqja 25 deri në këtë pikë.

Firmosur nga RICCI VINCENZO

Firmosur nga BAZZANI ANTONIETTA

Firmosur nga LAURA MAGAGLIO- Noteria (vula)

Kopja e marrë elektronikisht është konfrom dokumentit origjinal të printuar dhe marrë fizikisht, në bazë të nenit 22 të Dekretit Legjislativ 7 Mars 2005 nr.82 i ndryshuar nga Dekreti Legjislativ i datës 30 Dhjetor 2010, nr.235 për përdorimin e Regjistrit të Bizneseve.

Pagesa e pullës e bërë në bazë të Dekretit 22 Shkurt 2007 nga M.U.I

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Banka e Legnanos

SHOQËRI NË THEMELIM E SIPËR

- ☐ KËRKESË PËR PAGIMIN E 25% TË KAPITALIT
- ☒ KËRKESË PËR PAGESË TË PLOTË TË KAPITALIT

Agjensia 01037

Data 07.01.2013

Kompania e themeluar WELDER PIPELINE CONTRACTOR S.R.L (firma).....

(selia) Rruga PIONA ,1-155066 GAVI (AL) (objekti i shoqërisë) NDËRTIMI I TUBACIONEVE TË NAFTËS, TUBACIONEVE TË GAZIT DHE IMPIANTEVE INDUSTRIALE PËRFSHIRË PUNIMET E SALDIMIT (kapitali ne para) 10.000 euro

I nënshkruari RICCI VINCENZO banues në GAVI(AL)

Rruga PIONA, I kërkon të paguajë depozitën e përkohëshme n° 1

Në emër të anëtarëve të mëposhtëm:

☐ -25% e kapitalit të sipërpërmendur, sipas neneve

2342 k.c (rregullat për sh.p.k)

2454 k.c(rregullat e llogarinë e shoq.)

2464 k.c (rregullat për shoq.me përgj. të kufizuar)

☐ Pjesa e plotë e kapitalit , sipas neneve

2464 k.c (rregullat e njëanshmerisë së shoq.me përgj. të kufizuar

2342 k.c rregullat e njëanshmërisë së SH.A

Emër,Mbiemër,Shoqëria	Vendi,data e lindjes, kod fiskal, ose selia ligjore	Adresa	Pjesa e kuotave që zoterojnë
RICCI VINCENZO	LINDUR NË SEZZE(LT) NË 12.03.1943 CF RCCVCN43C121712E	RRUGA PIONA, 1-15066 GAVI(AL)	9900,00
BAZZANI ANTONIETTA	LINDUR NË GAVI(AL), NË 10.012.1944 CF BZZNNT44T50D994O	RRUGA PIONA, 1-15066 GAVI(AL)	100,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00

Shuma totale e paguar 10000 euro

10.000.00

(dhjetë mijë euro)

(firma)

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Banka e Legnanos

SHOQËRI NË THEMELIM E SIPËR

KËRKESË PËR PAGIMIN E 25% TË KAPITALIT

KËRKESË PËR PAGESË TË PLOTË TË KAPITALIT

Agjensia 01037

Data 07.01.2013

Kompania e themeluar WELDER PIPELINE CONTRACTOR S.R.L (firma).....

(selia) Rruga PIONA ,1-155066 GAVI (AL) (objekti i shoqërisë) NDËRTIMI I TUBACIONEVE TË NAFTËS, TUBACIONEVE TË GAZIT DHE IMPIANTEVE INDUSTRIALE PËRFSHIRË PUNIMET E SALDIMIT (kapitali ne para) 10.000 euro

I nënshkruari RICCI VINCENZO banues në GAVI(AL)

Rruga PIONA, 1 kërkon të paguajë depozitën e përkohëshme n° 1

Në emër të anëtarëve të mëposhtëm:

☐ 25% e kapitalit të sipërpërmendur, sipas neneve

2342 k.c (rregullat për sh.p.k)

2454 k.c (rregullat e llogarinë e shoq.)

2464 k.c (rregullat për shoq.me përgj. të kufizuar)

☐ Pjesa e plotë e kapitalit , sipas neneve

2464 k.c (rregullat e njëanshmërisë së shoq.me përgj. të kufizuar

2342 k.c rregullat e njëanshmërisë së sh.p.k

Emër,Mbiemër,Shoqëria	Vendi,data e lindjes, kod fiskal, ose selia ligjore	Adresa	Pjesa e kuotave që zoterojne
RICCI VINCENZO	LINDUR NË SEZZE(LT) NË 12.03.1943 CF RCCVCN43C12I712E	RRUGA PIONA, 1-15066 GAVI(AL)	9900,00
BAZZANI ANTONIETTA	LINDUR NË GAVI(AL), NË 10.012.1944 CF BZZNNT44T50D994O	RRUGA PIONA, 1-15066 GAVI(AL)	100,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00

Shuma totale e paguar 10000 euro

10.000,00

(dhjetë mijë euro)

(firma)

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



BANKA E LEGNANOS
AGJENSIA GAVI LIGURE

Arkëtari
(firma,)

(vula,firma)

Pulla	PARALAJMERIM Ndaj atyre që kanë bërë pagesën e 25% të kuotës në llogari të bankës, fatura e paguar nuk do të ketë asnjë efekt deri sa shoqëria të jetë regjistruar sipas ligjit. 25% i depozituar (neni 2342,2454 dhe 2464 k.c) ose pjesa e plotë e kapitalit (neni 2464 dhe 2342 k.c) duhet t'i rikthehen shoqërisë ose administratorëve. Në qoftë se ka kaluar një vit dhe shoqëria nuk është regjistruar akoma në regjistrin tregëtar, 25% e paguar do t'u kthehet personave që e kanë depozituar. Në çdo rast kjo faturë duhet të kthehet në Bankë në momentin e tërheqjes së 25% ose të pjesës së plotë të integruar të kapitalit.
-------	--

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Banka e Legnanos

SHOQËRI NË THEMELIM

KËRKESË PËR PAGIMIN E 25% TË KAPITALIT

KËRKESË PËR PAGESË TË PLOTË TË KAPITALIT

Agjensia 01037

Data 07.01.2013

Kompania e themeluar WELDER PIPELINE CONTRACTOR S.R.L (firma).....

(selia) Rruga PIONA ,1-155066 GAVI (AL) (objekti i shoqërisë) NDËRTIMI I TUBACIONEVE TË NAFTËS, TUBACIONEVE TË GAZIT DHE IMPIANTEVE INDUSTRIALE PËRFSHIRË PUNIMET E SALDIMIT (kapitali ne para) 10.000 euro

I nënshkruari RICCI VINCENZO banues në GAVI(AL)

Rruga PIONA, 1 kërkon të paguajë depozitën e përkohëshme n° 1

Në emër të anëtarëve të mëposhtëm:

☐ 25% e kapitalit të sipërpërmendur, sipas neneve

2342 k.c (rregullat për sh.p.k)

2454 k.c(rregullat e llogarinë e shoq.)

2464 k.c (rregullat për shoq.me përgj. të kufizuar)

☐ Pjesa e plotë e kapitali , sipas neneve

2464 k.c (rregullat e njëanshmerisë së shoq.me përgj. të kufizuar

2342 k.c rregullat e njëanshmerisë së sh.p.k

Emër,Mbiemër,Shoqëria	Vendi,data e lindjes, kod fiskal, ose selia ligjore	Adresa	Pjesa e kuotave që zoterojnë
RICCI VINCENZO	LINDUR NË SEZZE(LT) NË 12.03.1943 CF RCCVCN43C12I712E	RRUGA PIONA, 1-15066 GAVI(AL)	9900,00
BAZZANI ANTONIETTA	LINDUR NË GAVI(AL), NË 10.012.1944 CF BZZNNT44T50D994O	RRUGA PIONA, 1-15066 GAVI(AL)	100,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00
			0,00

Shuma totale e paguar 10000 euro

10.000,00

(dhjetë mijë euro)

(firma)

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Deklaroj se mora nga Banka e Legnanos kthimin e shumës së depozituar prej 25% dhe të kuotës së plotë të kapitalit me shumën totale 10000,00(dhjetë mijë,00) euro

Emri, mbiemri	Vendi,data e lindjes, kod fiskal	Cilësi e mbuluar nga kompania	Firma e faturës
RICCI VINCENZO	LINDUR NE SEZZE(LE) 12.03.1943 CF RCCVCN43C12I712E		

RIMBURSUAR	☐ E akredituar në regjistrin tregtar 479 në emër të WELDER PIPELINE CONTRACTOR S.R.L
	☐ nga drafti i bankes 'N.T' i Bankes së Legnano N..... në euro

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj




Unë e nënshkruara Laura Magaglio Notere në Ligure, e regjistruar pranë dhomës së Noterëve të Alessandrisë, Acqui Terme e Tortona, në bazë të Dekretit të Presidentit të Republikës, datë 28 Dhjetor 2000 nr.445, këtë kopje të përbërë nga 58 (pesëdhjetë e tetë) faqe e vërtetoj me origjinalen.

Novi Ligure, 08.01.2013



(Firma,vula)

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Kopje e dokumentit konform dokumentit origjinal, në bazë të nenit 22 të Dekretit Legjislativ të datës 07 Mars 2005 nr.82 i ndryshuar me Dekretin Legjislativ të datës 30 Dhjetor 2010 nr.235 për Regjistrin e Bizneseve.



(Firma, vula)

KRYESEKRETARE

Doc. Roberta Panzeri

Përgjegjësi i çështjes

Antonio Di Fazio



Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



Prefektura e Alessandria-s
Zyra e Rregullimit të Territorit të Prefekturës së Alessandria-s

Apostile

(Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961)

1. Republika e Italisë

Ky akt publik

2. Ky akt publik është firmosur

Nga ANTONIO DI FAZIO

3. Që operon si Përgjegjës i Procedimeve

4. Dhe mban vulen e CC.AA – ALESSANDRIA

Vërtetuar

5. Në ALESSANDRIA

6. Më 11/02/ 2020

6. Nga VILLAVECCHIA Rossana

7. Me numër 1339

8. Vula

10. Asistenti Administrativ

(firma, vula)

Përkthyes zyrtar: Erion Kabaj



ERION KABAJ
TRADUZIONI GIURATE
ALBANESE - ITALIANO
RICONOSCIUTO DAL MINISTERO DELLA GIUSTIZIA
DELLA REPUBBLICA D'ALBANIA